



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-1940/25
Kaçanik, 27.01.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **I (parë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27 janar 2025 (e Hënë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 09:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e I-të (parë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, data 27 janar, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ?

Procesverbali i mbledhjes së X-të (dhjetë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2024, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së X-të (dhjetë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024, të datës 17.12.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-31158/24.

2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025;

z.Ekrem Livoreka: Hapi diskutimin lidhur me planin e punës së Komitetit për komunitete, nëse keni ndonjë propozim.

z.Arben Thaqi: Lidhur me pikën dytë propozoj që "Gjendja e furnizimit me energji elektrike në komunën e Kaçanikut", të largohet nga plani i punës së Komitetit për Komunitete dhe të futet një pikë tjetër konkretisht, "Të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuar në komunën e Kaçanikut", të hy si aktivitet vizitë në institucionet HANDIKOS dhe respektimi i drejtave dhe kushteve të personave me aftësi kufizuar.

z.Ekrem Livoreka: Pika e tretë, "Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut", mbetet në plan të punës.

znj.Arta Avdiu: Lidhur me pikën e katërt propozoj që "Të drejtat e qytetarëve në komunën e Kaçanikut", të largohet nga plani i punës së Komitetit për Komunitete dhe të futet një pikë tjetër "Kushtet e Bujqëve në komunën e Kaçaniku", të hy si aktivitet takim me bujqit dhe vizit fermerve.

z.Betim Shala: Pika 5, "Ndarja e garantëve dhe subvencioneve për OJQ, mbetet në plan të punës. Pika 6, "Aktivitete rinore dhe sportive komunën e Kaçanikut", mbetet në plan të punës të komitetit për komunitete. Pikën 7-të, "Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut", mbetet në plan të punës.

znj.Lejla Muhaxheri-Çaka: Pika 8-të, "Rastet sociale në komunën e Kaçanikut" - mbetet në plan të punës.

Pika 9-të, "Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut" - mbetet në plan të punës.

z.Ekrem Livoreka: Pika 10-të, "Gjendja aktuale QKMF-së në komunën e Kaçanikut", të mbetet në planin e punës së Komitetit për Komunitete.

A jeni të pajtimit që ky plan i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025, ti përcillet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim?


Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025, u shtrua në votim dhe i njëjti u votua njëzëri. Me këtë konstatojmë që:

Plani i Punës së Komitetit për Komunitete, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3.Të ndryshme:

z.Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 10:45.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

